

Tiranë, 5.05.2018

GJETJET KRYESORE TË ANKETIMIT TË KRYER ME DELEGATËT E KUVENDIT KOMBËTAR TË PARTISË DEMOKRATIKE

29 PRILL 2018

Më 29 prill 2018 ekipi kërkimor i Institutit të Studimeve Politike (ISP) zhvilloi testim të një numri të madh delegatësh të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike. E njëjta praktikë është ndjekur më 2016 edhe në Kongresin e PS dhe më pas edhe në Konventën Kombëtare të LSI.

Ekipi studimor përbëhet nga pedagogë e studentë të shkencave politike të UT, UAMD dhe AU, të drejtuar nga Prof. Afrim Krasniqi. Në anketim u përfshinë 180 përgjigje të plota nga delegatët e PD, 5 përgjigje të pjesshme dhe vetëm në 2 raste pati refuzim për përgjigje. Gatishmëria për përgjigje ishte një zhvillim pozitiv dhe një dalim thelbësor nga vitet e mëparshme 2005 dhe 2014. Anketimi u bë duke bërë shpërndarje horizontale në moshë, gjini, përbërje sociale, prurje nga degët dhe qendra, zyrtarë të lartë dhe anëtarë të thjeshtë, etj.

Për informacion: Instituti i Studimeve Politike ka në dispozicion edhe anketime të njëjta të bëra në Kuvendin Kombëtar të PD më 2005, pra 13 vjet më parë, si dhe më 2014, pra 4 vjet më parë. Të dhënat e tri kuvendeve (2005, 2014, 2018) ofrojnë gjetje interesante që lidhen për përbërjen e Kuvendit, me statusin shoqëror e social të delegatëve, me formimin e tyre politik, me përkatësinë fetare e gjinore, si dhe sidomos me perceptimet e tyre mbi demokracinë e brendshme partiake dhe problematika themelore të politikës.

ISP ka bërë gjithashtu anketime të tilla edhe në Kongresin e PS 2016 dhe disponon të dhëna profesionale mbi Kongresin e PS më 2005, me distancë kohore 11 vjeçare. Të dhënat e Kuvendeve të PD dhe të Kongreseve të PS kanë vlerë specifike sepse ofrojnë mundësi për analizë krahasimore mbi secilën parti, mbi perceptimet e delegatëve, mbi demokracinë partiake dhe tematika të tjera prioritare.

Studimi i plotë me të dhënat krahasuese për secilën nga rastet e cituara më lart, përfshirë analizën e detajuar mbi pyetëtorin e zhvilluar në Kuvendin e PD 2018, do të publikohet në muajin e ardhshëm nga stafi kërkimor i Institutit të Studimeve Politike.



GJETJET KRYESORE TË ANKETIMIT

1. **MARRËVESHJA RAMA – BASHA.** Numri i delegatëve që janë kritik me marrëveshjen politike Rama – Basha në maj 2017 është 4% më i lartë sesa numri i atyre që japin vlerësime pozitive për këtë marrëveshje. Rreth 11% kanë opinion të ndërmjetëm, duke konsideruar elementë të tjerë pozitivë / negativë në marrëveshjen dhe ecurinë e saj gjatë procesit zgjedhor.
2. **MINISTRAT TEKNIKË.** Shumica e delegatëve, në raportet 46% me 42% japin vlerësim pozitiv për ministrat teknikë dhe rolin e tyre në qeveri. Kjo e dhënë është interesante, pasi përqindja e atyre që janë pro marrëveshjes (42%) është e barabartë me ata që kanë vlerësim negativ për ministrat teknikë dhe rolin e tyre.
3. **PAKT I RI PD – PS PËR REFORMA.** Rreth 12% më shumë delegatë refuzojnë që në të ardhmen të ketë një marrëveshje të re ose vijim të marrëveshjes politike midis PD e PS lidhur me reformat. Nga totali i të anketuarve rezulton se 51% janë kundër një pakti të ri politik, 39% janë pro dhe 7% kanë mendim alternativ.
4. **KOALICIONI PD – LSI 2019/2021.** Në kulmin e partneritetit aktiv midis PD e LSI, më shumë se gjysma e delegatëve të PD (54%) janë kundër një koalicioni zgjedhor 2019 dhe 2021 me LSI. Përqindja e atyre që janë pro këtij koalicioni është 37%, pra 2% më pak sesa ata që mbështetin një marrëveshje politike me PS. Preferenca një pakti të ri politik me PS ose vijim të marrëveshjes aktuale me të, në dy rastet është më e lartë sesa koalicioni elektoral me LSI. Kjo e dhënë është interesante edhe për faktin se LSI ka qenë pjesë e koalicionit me PD më 2009-2013 dhe se aktualisht “de facto” është pjesë e aksionit politik të opozitës.
5. **SISTEMI ZGJEDHOR.** 95% e delegatëve janë kundër sistemit aktual zgjedhor proporcional me lista të mbyllura, 45% duan sistem me lista të hapura dhe 40% duan sistem të pastër mazhoritar. Në dy rastet shumica absolute e delegatëve janë në koherencë me premtimin e njëjtë të dhënë në ligjërimin mbi “republikën e re”, por në kontrast me qëndrimin zyrtar aktual të dy partive të mëdha për mos-ndryshimin e sistemit zgjedhor.
6. **ZGJEDHJA E PRESIDENTIT.** Lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës delegatët e PD janë të qartë, dhe dukshëm në kontrast me praktikën aktuale: 83% mbështetin zgjedhjen direkt të Presidentit nga qytetarët, vetëm 13% mbështetin formulën aktuale të zgjedhjes nga parlamenti dhe 4% kanë opinion të ndërmjetëm.
7. **KRIJIMI I SENATIT.** Delegatët u pyetën nëse janë mbështetës të ndryshimit kushtetues të premtuar në paketën e Republikës së Re, për kalim të sistemit aktual parlamentar në një sistem me dy dhoma, me një parlament përfaqësues dhe një senat balancues në përfaqësimin politik: përqindja e delegatëve pro senatit është vetëm 2% më e lartë sesa e atyre që janë kundër këtij ndryshimi. Kjo e dhënë është interesante për vetë faktin se senati ka kaq shumë mbështetje, ndërkohë që në axhendën politike aktuale askush nuk flet për këtë problematikë.



8. **KRYEMINISTER PARTIAK VS TEKNIK.** Gjatë vitit 2017 PD protestoi duke kërkuar një qeveri teknike, kurse gjatë fillimit të vitit 2018 ajo hodhi tezën e një qeverie të re teknike anti-mafia. Në dy rastet ideja ishte më afër zgjidhjes së një kryeministri jo politik, pra një figurë teknike. Të dhënat e delegatëve janë të ndryshme nga ky perceptim: 65% janë kundër tezës që kryeministri të jetë një figurë jo partiake, dhe vetëm 33% janë në favor të kësaj teze.
9. **VETINGU NË POLITIKË.** Vettingu në drejtësi është headline në agjendën politike shqiptare. Delegatët e Kuvendit të PD u pyetën nëse janë mbështetës të idesë që pas vettingut në drejtësi të ketë edhe vetting në politikë. Përgjigjja është pozitivisht befasuese: 93% e delegatëve duan të ketë edhe vetting për politikanët dhe ky është një vullnet i qartë kundër politikanëve të korruptuar, përfshirë edhe atyre në PD.
10. **BLERJA E VOTAVE 2017.** Delegatët u pyetën nëse ende besojnë se votat e PD në zgjedhjet parlamentare 2017 janë blerë duke sjellë humbjen e saj. 83% konfirmuan këtë tezë dhe vetëm 17% mendojnë ndryshe. Përgjigja shpreh perceptim publik dhe ka të bëjë edhe me frymën sesi në PD lexohet humbja e zgjedhjeve të fundit parlamentare.
11. **BLERJA E VOTAVE NË PARTITË POLITIKE.** Delegatët u pyetën më pas nëse fenomeni i blerjes së votave është i përhapur edhe brenda vetë partive politike, në zgjedhjet e brendshme të tyre. Në këtë rast Kuvendi i PD ishte i ndarë: 53% mendojnë se jo, 45% mendojnë se po dhe pjesa tjetër ka qëndrim alternativ. Fakti se 45% konfirmon trafikun e votës brenda partive është konfirmues për problematikat e zgjedhjeve dhe kulturën politike brenda partive.
12. **DEKRIMINALIZIMI DHE PARTITË.** Delegatët u pyetën nëse personat e akuzuar për krime dhe korrupsion do të duhet të përjashtohen nga partitë politike, pasi aktualisht kjo gjë nuk ndodh. Përgjigja ishte dukshëm konfirmuese: 88% mendojnë se ata duhen përjashtuar dhe vetëm 7% mendojnë të kundërtën. Pjesa tjetër ka qëndrim alternativ. Ky është një përfundim i rëndësishëm dhe nxitës që procesi i dekriminalizimit të aplikohet edhe brenda partive.
13. **TË KORRUPTUARIT NË PARTI POLITIKE.** Delegatët u pyetën specifikisht nëse në partitë politike, përfshirë PD-në, ka elementë të korruptuar. Përgjigjja ishte konfirmuese në vlerë absolute: 94% konfirmuan se ka të korruptuar në partitë politike përfshirë PD. Vetëm 4% mohojnë këtë pohim. Përqindja e lartë është konfirmuese për perceptimin publik për korrupsionin në partitë dhe elitat politike në vend.
14. **VOTIMI I EMIGRANTËVE.** Pyetja lidhur me votimin e emigrantëve lidhet me tematikën politike të ditës dhe kërkesës së ardhur nga PS. Pavarësisht nga kjo, 86% e delegatëve të PD janë konfirmues dhe dakord për votimin e emigrantëve dhe vetëm 12% janë refuzues.
15. **VOTIMI ELEKTRONIK.** Pyetja lidhet me kërkesën politike të PD për përdorimin e teknologjive elektronike në zgjedhjet e ardhshme. Edhe në këtë rast, 89% e delegatëve japin vlerësim konfirmues pro votimit elektronik dhe vetëm 8% kanë opinion të kundërt.
16. **DEPOLITIZIMI I KOMISIONEVE ZGJEDHORE.** bazuar edhe në rekomandimin e ODIHR/OSBE delegatët u pyetën nëse komisionet e votimit në zgjedhjet lokale e parlamentare duhet të jenë jo partiake, pra të depolitizuara. Interesant është përgjigjja: 54% e delegatëve të anketuar, pra më shumë se gjysma e tyre, janë konfirmues dhe kundër komisioneve



partiakë në zgjedhje, kurse 39% janë kundër alternativës, pra për vijimin me komisionerë partiak në zgjedhje.

GJETJE NE LIDHJE MË PËRBËRJEN DHE SPECIFIKA TË PD

17. **IDENTIFIKIMI IDEOLOGJIK.** Lidhur me identifikimin ideologjik rezulton se dominues me 41% është kategoria që quhet e djathtë për shkak të traditës familjare, 15% sepse janë ish të përndjekur politikë, 11% sepse janë apriori kundër kryeministrit Rama dhe PS, 11% sepse besojnë tek iniciativa e lirë në biznes dhe vetëm 5% për shkak të identifikimit me liderin politik. Dominimi i traditës familjare ka rol kufizues në konkurrencën politike, në procesin politikbërës / debatin politik, si dhe në raportet vlere-shtet-pushtet-parti.
18. **VLERËSIMI PËR CILËSITË E KRYETARIT BASHA.** Lidhur me vlerësimin ndaj cilësive të kryetarit Basha rezulton se 68% konsiderojnë cilësi më të mirë të tij qenien më pozitiv sesa kryetari i PS Rama, 58% e mendojnë maksimalisht të ndershëm dhe të pakorruptueshëm, 56% vlerësojnë maksimalisht aftësinë për ndryshime, vetëm 50% e delegatëve të anketuar besojnë se ka aftësi maksimale të fitojë zgjedhjet dhe vetëm 44% mendojnë se ai e drejton maksimalisht në mënyrë demokratike PD-në.
19. **VJETËRSIA E ANËTARËVE.** Anëtarësia e PD bazuar në të dhënat e delegatëve ka mbetur besnike prej vitit 1991-1992 (në 41% të rasteve të anketuara), dhe se përqindja e delegatëve që shënojnë prurje të viteve të fundit në PD është simbolike, më e vogël sesa në PS e LSI (vetëm 4%).
20. **PUNËSIMI.** Duke qenë parti në opozitë dhe me mundësi të kufizuara punësimi në shtet, 48% e delegatëve të anketuar deklarojnë se punojnë në biznesin privat pro vetëm 11% pranojnë se janë direkt ose indirekt biznesmenë. Shqetësues është fakti se 22% deklarojnë se janë të papunë, atipike kjo për një parti politike alternativë për pushtet. Numri i madh i delegatëve pa marrëdhënie punësimi shpreh gjendjen kritike sociale në parti dhe kufizon aftësitë politike të saj.
21. **PËRBËRJA FETARE.** PD vijon të dominohet nga anëtarë që kanë identitet fetar (98%) dhe ku vetëm 2% deklarohen ateistë. Nga besimtarët delegatët me besimin mysliman janë shumicë (62%) ndjekur nga katolikët (17%), ortodoksët (10%), bektashi (4%), etj. Raportet fetare janë thuajse të njëjta me përbërjen fetare të vitit 2005, pra kanë bazë të qëndrueshme.
22. **PËRBËRJA MOSHORE.** Grupmosha kryesore e delegatëve të PD është 35-49 vjeç (41%), ndjekur nga grupmosha 50-64 vjeç (32%). Të rinjtë dhe pensionistët zënë përkatësisht vetëm 7% dhe 6% të numrit të delegatëve të anketuar.
23. **PËRBËRJA GJINORE.** Pjesa më e madhe e delegatëve të PD (mbi dy të tretat) dominohet nga gjinia mashkullore. Femrat zënë përqindje dytësore në përfaqësimin në Kuvend dhe në grupin e të anketuarve (26%).

